



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 844/12 prot.,

Datë 22.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 535/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 481/2026, datë 08.04.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër milion e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë  
Lagjja Kushtrimi, ish Parku i Autobusave, Vlorë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK me Nipt J81426001I dhe adresë:, Rruga “Xhorxhi Martini” Pall Ri 9 kate, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 08.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 481/2026, ku vendosi:

[.....]

- 1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit me “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.*
- 2. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK për procedurën e prokurimit me “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.*
- 3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit MILIFAR” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK.*

7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

8. *Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]*

I.2. Me shkresën nr. 198/36 prot., datë 14.04.2026, protokolluar me tonën nr. 844/8 prot., datë 17.04.2026, dhe shkresën nr. 198/37 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën nr. 844/8 prot., datë 207.04.2026 autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 481/2026 datë 08.04.2026, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 10.04.2026.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 198/36 prot., datë 14.04.2026, protokolluar me tonën nr. 844/8 prot., datë 17.04.2026, dhe shkresën nr. 198/37 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën nr. 844/8 prot., datë 207.04.2026 autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 481/2026 datë 08.04.2026, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 10.04.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 4818/2026, datë 08.04.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër milion e tetëqind

e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

